

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 18.01.2025

1. Pasqyrat financiare të mëposhtme kanë të bëjnë me Belushi sh.a dhe Dushku sh.a:

Ekstrakt i pasqyrës së fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024

	Belushi sh.a	Dushku sh.a
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	122,500	75,000
Investimet në Dushku sh.a	<u>58,000</u>	<u>-</u>
	180,500	75,000
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Të arkëtueshmet tregtare (shënim iv)	39,500	34,900
Stoqet	20,000	5,000
Paraja	<u>10,000</u>	<u>5,000</u>
	<u>69,500</u>	<u>44,900</u>
Total pasuritë	250,000	119,900
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti:</i>		
Aksionet e zakonshme (emetuar me €0.50 secila)	50,000	20,000
Fitimet e mbajtura	89,700	46,400
Rezervat tjera	<u>16,300</u>	<u>3,500</u>
	156,000	69,900
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
Kreditë afatgjata	35,000	14,000
<i>Detyrimet afatshkurtra:</i>		
Të pagueshmet tregtare (shënim iv)	<u>59,000</u>	<u>36,000</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	250,000	119,900

Informata shtesë:

- i) Belushi sh.a bleu 30 milionë aksione të zakonshme të Dushku sh.a më 1 janar 2023 kur vlera kontabël e pasurive neto të Dushku sh.a ishte €58 milionë. Dushku sh.a as nuk ka emetuar asnjë aksion dhe as nuk ka parë ndonjë ndryshim në rezervat e tjera të saj që nga blerja e aksioneve nga Belushi sh.a.
- ii) Një vlerësim i vlerës së drejtë në kohën e blerjes së Dushku sh.a-së nxorri në pah çështjet e mëposhtme:
 - Një zë i pajisjes me vlerë reale kontabël prej €10 milionë kishte një vlerë të drejtë të vlerësuar prej €16 milionë. Jeta e dobishme ekonomike e mbetur e vlerësuar e kësaj pajisjeje në datën e blerjes ishte gjashtë (6) vjet.

- Një projekt hulumtimi dhe zhvillimi ishte në proces në momentin e blerjes që plotësonte kriteret e njohjes të SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*. Në atë datë, vlera e drejtë e projektit ishte €5 milionë dhe nuk ishte njohur asnjë vlerë në libra. Projekti filloi të gjenerojë përfitime ekonomike një vit më parë dhe pritet të kontribuojë për katër vite të tjera.
- Rregullimet e mësipërme bënë të nevojshme provizionin e tatimit të shtyrë prej €1 milion në datën e blerjes. Deri më 31 dhjetor 2023, provizioni i kërkuar ishte reduktuar në €0.9 milion, dhe deri më 31 dhjetor 2024 ishte reduktuar më tej në €0.7 milion.

Dushku sh.a nuk ka përfshirë ende rregullimet e mësipërme të vlerës së drejtë në pasqyrat e veta financiare.

- iii) Gjatë vitit, Belushi sh.a ka shitur mallra me vlerë €25 milionë te Dushku sh.a dhe ka aplikuar një marzhë prej një të tretës së kostos në përcaktimin e çmimit të shitjes. Më 31 dhjetor 2024, stoqet e Dushku sh.a-së përfshinin €4.8 milionë në lidhje me mallrat e furnizuara nga Belushi sh.a. Injoroni implikimet e tatimit të shtyrë për këta zëra.
- iv) Të arkëtueshmet tregtare të Belushi sh.a përfshinin €8 milionë të arkëtueshme nga Dushku sh.a. Ky bilanc nuk përputhej me të pagueshmet ekuivalente të pagueshme në librat e Dushku sh.a për shkak të pagesës prej €2 milionë të kryer më 31 dhjetor 2024 nga Dushku sh.a te Belushi sh.a.
- v) Është politike e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas sipas vlerës së plotë (të drejtë) të pasurive neto të identifikueshme të degës (filialit). Vlera e drejtë për aksion të zakonshëm në Dushku sh.a në momentin e blerjes ishte €1.50 dhe mund të përdoret për këtë qëllim.
- vi) Zëri i mirë u dëmtua me 10% për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Një dëmtim i mëtejshëm prej 10% të zërit të mirë të mbetur më 31 dhjetor 2023 është i nevojshëm në periudhën aktuale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Grupit Belushi sh.a më 31 dhjetor 2024. (20 pikë)

1.

Grupi Belushi sh.a**Pasqyra e Konsoliduar të Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2024**

€'000

Pasuritë

Pasuritë jo-qarkulluese:

Prona, fabrika dhe paisjet (€122,500 + €75,000 + €6,000 - €2,000) 201,500

Projekti i hulumtimit dhe zhvillimit (€5,000 - €1,000 LI2) 4,000

Zëri i mirë (LI3) 4,050

209,550

Pasuritë qarkulluese:

LI/ A tregtare (€39,500 + €34,900 - €8,000) 66,400

Stoqet (€20,000 + €5,000 - €1,200) 23,800

Paraja (€10,000 + €5,000 + €2,000) 17,000107,200**Total pasuritë****316,750****Ekuiteti dhe detyrimet**

Aksionet e zakonshme 50,000

Fitimet e mbajtura (LI5) 94,687.5

Rezervat tjera 16,300

160,987.5

Interesi jo-kontrollues (LI4) 17,062.5

178,050

Detyrimet afatgjata:

Kredia (€35,000 + €14,000) 49,000

Tatimi i shtyrë 700

Detyrimet afatshkurtra:

LI/P tregtare (€59,000 + €36,000 - €6,000) 89,000138,700**Total ekuiteti dhe detyrimet****316,750****Llogaritjet****1. Struktura e grupit**

Belushi sh.a 30 milion aksione / 40 milion aksione = 75 % Prindi, 25 % IJK

2. Neto pasuritë e Dushku sh.a

	Në datën e blerejes	Në datën e raportimit	Pas blerjes
	€'000	€'000	€'000
Aksionet e zakonshme	20,000	20,000	-
Fitimet e mbajtura (58,000 - 20,000 - 3,500)	34,500	46,400	11,900
Rezervat tjera	3,500	3,500	-
Korigjimet e VD - fabrika (16,000-10,000)	6,000	6,000	-
Zhvlerësimi shtesë (6,000 / 6 x 2)	-	(2,000)	(2,000)
Puna në progres - hulumtimi dhe zhvillimi	5,000	5,000	-
Amortizimi i hulumtimit dhe zhvillimit (5,000 / 5)	-	(1,000)	(1,000)
Tatimi i shtyrë	<u>(1,000)</u>	<u>(700)</u>	<u>300</u>
	68,000	77,200	9,200

3. Zëri i mirë	€'000
Kosto e investimit	58,000
Vlera e drejtë e IJK në blerje $[(40,000 - 30,000) \times 1.50]$	<u>15,000</u>
	73,000
Minus: neto pasuritë e filialit në blerje LI2	<u>(68,000)</u>
Zëri i mirë në blerje	<u>5,000</u>
10% humbje nga dëmtimi (për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2023)	<u>(500)</u>
Zëri i mirë me 31 dhjetor 2023	4,500
10% humbje nga dëmtimi (për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2024)	<u>(450)</u>
Zëri i mirë në datën e raportimit	4,050

Shënim: Dëmtimi total i zërit të mirë që nga blerja është €950,000 (€500,000 + €450,000).

4. Interesi jo-kontrollues	€'000
Vlera e drejtë e IJK në blerje $(40,000 - 30,000) \times 1.5$	15,000
Pjesa e fitimeve të filialit pas blerjes $(9,200 \times 25\%)$	2,300
Pjesa e humbjeve nga dëmtimi $(25\% \times 950)$	<u>(237.5)</u>
IJK në datën e raportimit	17,062.5

5. Fitimet e mbajtura të grupit	€'000
Belushi sh.a	89,700
Fitimi i parealizuar në stoke në fund të vitit $(1 / 4 \times 4,800)$	(1,200)
Pjesa e fitimeve të mbajtura të filialit pas blerjes $(75\% \times €9,200)$	6,900
Pjesa e humbjeve nga dëmtimi $(75\% \times 950)$	<u>(712.5)</u>
	94,687.5

2.

a) Viti kontabël i Lusha sh.a fillon nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Në vitin që përfundon në dhjetor 2022 dhe 2023, Lusha sh.a realizoi një fitim kontabël pas tatimit dhe pas dividendes preferenciale prej €90,000,000 dhe €100,000,000 respektivisht. Në fillim të vitit 2022, Lusha sh.a kishte 100,000 aksione të zakonshme, dhe nuk emtoi aksione shtesë në vitin 2022. Më 30 qershor 2023, Lusha sh.a emtoi 20,000 aksione të zakonshme me vlerën e plotë të tregut.

Gjatë vitit që përfundon në dhjetor 2024, Lusha sh.a realizoi një fitim kontabël pas tatimit prej €110,000,000. Kompania kishte marrë më 1 janar 2024 një kredie të konvertueshme prej €10,000,000 me norme interesi 20%. Kredia është e konvertueshme në 1 aksion të zakonshëm për çdo €1,000 të kredisë. Kjo kredi nuk u konvertua deri më 31 dhjetor 2024. Norma e tatimit ka qenë gjithmonë 30%.

Kërkohet:

- i) Në përputhje me SNK 33 *Fitimet për Aksion*, dalloni shkurtimisht fitimin themelor për aksion (FPA themelore) dhe fitim e dobësuar për aksion (FPA e dobësuar). (2 pikë)
 - ii) Llogaritni fitimin themelor për aksion (FPA-në themelore) për vitin që përfundon në dhjetor 2022 dhe 2023. (4 pikë)
 - iii) Llogaritni fitimin themelor për aksion (FPA-në themelore) dhe fitimin e dobësuar për aksion (FPA-në e dobësuar) për vitin që përfundon në 2024. (6 pikë)
- (Total: 12 pikë)**

b) Logoreci sh.a bleu një kamion që kushtoi €20,000. Kamioni pritet se do funksionojë për pesë vjet dhe pastaj të shitet si mbeturinë për €5,000. Përdorimi gjatë pesë viteve pritet të jetë:

Viti 1	200 ditë
Viti 2	100 ditë
Viti 3	100 ditë
Viti 4	150 ditë
Viti 5	50 ditë

Kërkohet:

Llogaritni zhvlerësimin që duhet të ngarkohet për çdo vit sipas:

- i) Metodës drejtvizore (2 pikë)
 - ii) Metodës së saldës zbritëse (duke përdorur shkallën prej 25%) (2 pikë)
 - iii) Metodës së punëve të makinës (2 pikë)
 - iv) Metodës së shumës së shifrave (2 pikë)
- (Total: 8 pikë)**

a)

i) Dallimi midis fitimeve themelore për aksion dhe fitimeve të dobësuara për aksion

FPA-ja themelore llogaritet duke pjesëtuar fitimin ose humbjen neto për periudhën që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm me numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme në emetim gjatë periudhës.

FPA-ja e dobësuar llogaritet duke rregulluar fitimin neto që është krijuar nga operacionet e vazhdueshme që i atribuohet aksionarvë të zakonshëm dhe numrin mesatar të ponderuar të aksioneve në emetim për efektet e të gjitha aksioneve potenciale dobësuese

ii) FPA-ja themelore për aksion për vitin e përfunduar me 2022 dhe 2023.

	2023	2022
Duke marrë parasysh emetimin e aksioneve më 30 qershor, që është mesi i vitit, duhet të llogarisim numri mesatar i ponderuar i aksioneve:		
100,000 x 6/12	50,000	-
120,000 x 6/12	60,000	-
Aksionet:	110,000	100,000
Fitimet:	€100,000,000	€90,000,000
FPA themelore: Fitimet / Aksionet	€909.09 për aksion	€900 për aksion

iii) Fitimet themelore për aksion, fitimet e dobësuara për aksion për vitin që përfundon në 2024.

	2024
Para se të merret në konsideratë kredia e konvertueshme, FPA themelore do të jetë:	
Aksionet me 31 dhjetor 2024	120,000
Fitimi pas tatimit dhe dividendes preferenciale	€110,000,000
FPA themelore	€916.67 për aksion

Pasi të merret në konsideratë kredia e konvertueshme, FPA themelore do të jetë:

Numri i aksioneve të zakonshme shtesë për shkak të konvertimit të kredisë të konvertueshme:	
10,000,000 x 1/1000 =	10,000
Kursimet e kostos së interesit pas tatimit për shkak të konvertimit të kredisë të konvertueshme:	
10,000,000 x 20% x 70% =	€1,400,000
Numër i ri i aksioneve të zakonshme (përfshirë aksionet e zakonshme të konvertuara) 120,000 + 10,000 =	130,000
Fitimi i ri pas tatimit (përfshirë koston e interesit kursimet pas konvertimit të kredisë)	
110,000,000 + 1,400,000 =	111,400,000
FPA e dobësuar 111,400,000 / 130,000 =	€856.92 për aksion

b)

(i) Sipas metodës drejtvizore, zhvlerësimi për secilin prej pesë viteve është:

Zhvlerësimi vjetor = $(20,000 - 5,000) / 5$ vite = **€3,000 në vit**

(ii) Duke përdorur metodën e saldos zbritëse, zhvlerësimi për secilin prej pesë viteve është:

Viti	Zhvlerësimi
1	$25\% \times €20,000 = €5,000$
2	$25\% \times (€20,000 - €5,000) = 25\% \times €15,000 = €3,750$
3	$25\% \times (€15,000 - €3,750) = 25\% \times €11,250 = €2,812.5$
4	$25\% \times (€11,250 - €2,812.5) = 25\% \times €8,437.5 = €2,109.375$
5	Saldoja për ta sjellur vlerën në libra në €5,000 = $€8,437.5 - €2,109.375 - 5,000 = €1,328.125$

(iii) Duke përdorur metodën e orëve të punës së makinës, zhvlerësimi për secilin prej pesë viteve është:

Përdorimi gjithsej (ditë) = $200 + 100 + 100 + 150 + 50 = 600$ ditë

Zhvlerësimi për ditë = $(20,000 - 5,000) / 600 = €25$

Viti	Përdorimi (ditë)	Zhvlerësimi (€) (ditë × €25)
1	200	5,000
2	100	2,500
3	100	2,500
4	150	3,750
5	50	<u>1,250</u>
		15,000

(iv) Metoda e shumës së shifrave fillon duke iu shtuar vitet e jetës së pritur. Në këtë rast, $5 + 4 + 3 + 2 + 1 = 15$.

Suma e zhvlerësueshme prej €15,000 pastaj do të shpërndahet si në vijim:

Viti	
1	$15,000 \times 5/15 = 5,000$
2	$15,000 \times 4/15 = 4,000$
3	$15,000 \times 3/15 = 3,000$
4	$15,000 \times 2/15 = 2,000$
5	$15,000 \times 1/15 = 1,000$

3. Bilanci i vertetues i Dobroshi sh.a më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

	€'000	€'000
Të hyrat (shënim i)		323,150
Kosto e shitjeve	150,000	
Kosto e shpërndarjes	22,500	
Shpenzimet administrative	26,500	
Dividenda e paguar	1,900	
Interesi ndaj bankës	600	
Interesi i paguar ndaj notave të kreditit 10%	4,000	
Ndërtesa sipas vlerësimit 31 dhjetor 2023 (shënim ii)	100,000	
Fabrika dhe pajisjet sipas koston (shënim ii)	155,000	
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2024 - fabrika dhe pajisjet		35,500
Stoqet me 31 dhjetor 2024	51,000	
Të arkëtueshmet tregtare	49,200	
Të pagueshmet tregtare		25,600
Banka		5,700
Aksionet e zakonshme €0.5 secila (shënim iv)		60,500
Premia e aksioneve (shënim iv)		32,500
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2024		33,450
10% Nota krediti (shënim iii)		38,000
Tatimi aktual (shënim v)		2,800
Tatimi i shtyrë (shënim v)		<u>3,500</u>
	<u>560,700</u>	<u>560,700</u>

Shënimet e mëposhtme janë të rëndësishme:

- i) Të ardhurat përfshijnë €20 milionë të marra më 1 korrik 2024 nga një klient si pagesë paradhënie (avans) për mallrat që Dobroshi sh.a do të dorëzojë më 30 qershor 2025. Dobroshi sh.a normalisht merr kredi për të financuar operacionet e saj tregtare me një normë interesi prej 10%.
- ii) Dobroshi sh.a ka adoptuar politikën e rivlerësimit sipas SNK 16 *Prona, fabrika dhe pajisjet* në lidhje me ndërtesën e saj. Ndërtesa e cila ka kushtuar €125 milionë më 1 janar 2019 dhe jeta e dobishme totale ekonomike e së cilës vlerësohet në 50 vjet është rivlerësuar për herë të fundit më 31 dhjetor 2023. Ndërtesa është zhvlerësuar në bazë lineare me një vlerë të mbetur zero. Zhvlerësimi i ndërtesës duhet të përfshihet në koston e shitjes. Ndërtesa ende nuk është rivlerësuar në 31 dhjetor 2024 në një vlerë të drejtë prej €115 milion.

Fabrika dhe pajisjet zhvlerësohen me 15% në bazë të saldosh zbritëse. Zhvlerësimi i fabrikës dhe pajisjeve përfshihet në koston e shitjes.
- iii) Dobroshi sh.a emetoi 40 milionë nota krediti me vlerë nominale €1 me interes 10% me 1 janar 2024 më me një zbritje prej 5%. Notat e kreditit paguajnë interes më 31 dhjetor të çdo viti gjatë afatit të tyre 3-vjeçar deri në maturim. Notat e kreditit do të blihen në vleren nominale prej €1 më 31 dhjetor 2026 duke dhënë një normë efektive të interesit prej 12.11%. Detyrimi në lidhje me notat e kreditit në bilancin e mësipërm vertetues paraqet të ardhurat e pranuar në emetim.

- iv) Më 1 korrik 2024, Dobroshi sh.a emetoi 16.8 milionë aksione të zakonshme me një premi prej 25% dhe pas këtij emetimi bëri një emetim bonus për të gjitha aksionet ekzistuese, përfshirë ato të reja, në një raport prej një aksioni bonus për çdo katër aksione ekzistuese. Emetimi bonus u financua nga rezerva e premisë së aksioneve. Të dyja emetimet e aksioneve tashmë janë kontabilizuar dhe përfshirë në bilancin vertetues më sipër.
- v) Saldo e tatimit aktual përfaqëson nën/mbi provizionimin e detyrimit tatimor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Kërkohet një provizion prej €19 milionë për tatimin aktual për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 dhe në këtë datë, detyrimi i tatimit të shtyrë është vlerësuar në €4.1 milionë.

Kërkohet:

- a) Përgatiteni Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse për Dobroshi sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. (9 pikë)
- b) Përgatiteni Pasqyrën e Pozitës Financiare për Dobroshi sh.a më 31 dhjetor 2024. (8 pikë)
- c) Përgatiteni Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet për Dobroshi sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. (3 pikë)

(Total: 20 pikë)

Shënim: Rrubullakësoni në mijëra euro më të përafërt

(a) **Dobroshi sh.a**
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse
për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	€'000
Të hyrat (323,150-20,000)	303,150
Kosto e shitjeve (L11)	<u>(170,147)</u>
Fitimi bruto	133,003
Kosto e shpërndarjes	(22,500)
Shpenzimet administrative	(26,500)
Përfitimi nga rivlerësimi (L13)	<u>12,222</u>
Fitimi operativ	96,225
Kosto financiare (40,000 x €1 x 0.95 x 12.11% + 600 + 10% x 20,000 x 6/12)	<u>(6,202)</u>
Fitimi para tatimit	90,023
Tatimi në fitim (L12)	<u>(16,800)</u>
Fitimi për vitin	73,223
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Rivlerësimi i ndërtesës (L13)	<u>5,000</u>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin	78,223

(b) **Dobroshi sh.a**
Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2024

Pasuritë	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (L14)	216,575
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet	51,000
Të arkëtueshmet tregtare	<u>49,200</u>
Total pasuritë	316,775
Ekuiteti dhe detyrimet	
<i>Ekuiteti:</i>	
Aksionet e zakonshme prej €0.5 secila	60,500
Premia e aksioneve	32,500
Rezerva e rivlerësimit (L13)	5,000
Fitimet e mbajtura (33,450 - 1,900 + 73,223)	<u>104,973</u>
Total ekuiteti	202,773
<i>Detyrimet afatgjata:</i>	
10% nota krediti (€1 x 40,000 x 0.95)	38,000
Tatimi i shtyrë	<u>4,100</u>
	42,100
<i>Detyrimet afatshkurtra:</i>	
Mbitërheqja bankare	5,700
Të pagueshmet tregtare	25,600
Tatimi aktual	19,000
Detyrimi ndaj avansit (20,000 + 10% x 20,000 x 6/12)	21,000
Interesi akrual i 10% notave të kreditit(12.11% x 38,000 - 4,000)	<u>602</u>
	71,902
Total ekuiteti dhe detyrimet	316,775

(c)

Dobroshi sh.a**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024.**

	Aksionet e zakonshme	Premia e aksioneve	Rezerva e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Total
	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000
Saldo me 1 janar 2024 (L15)	40,000	42,500		33,450	115,950
Ndryshimi për vitin:					
Total TGJ			5,000	73,223	78,223
Dividenda				(1,900)	(1,900)
Emetimi i aksioneve VD (L15)	8,400	2,100			10,500
Emetimi bonus (L15)	<u>12,100</u>	<u>(12,100)</u>			
Saldo me 31 dhjetor 2024	60,500	32,500	5,000	104,773	202,773

Llogaritjet:

L11. Kosto e shitjeve	€'000
Sipas bilancit vertetues	150,000
Korigjimet	
Ngarkesa e zhvlerësimit:	
- Ndërtesa 100,000/(50-5)	2,222
- Fabrika dhe paisjet 15%(155,000-35,500)	<u>17,925</u>
	170,147

L12. Shpenzimet e tatimit në fitim	€'000
Tatimi aktual:	
- Provizionimi i detyrimit për v/p me 31 dhjetor 2024	19,000
- Mbi provizionimi i detyrimit për v/p me 31 dhjetor 2023	(2,800)
Kritja në detyrimin e tatimit të shtyrë (4,100-3,500)	<u>600</u>
	16,800

L13. Rivlerësimi i ndërtesës	€'000
Vlera e drejtë për tu raportuar me 31 dhjetor 2024	115,000
Vlera bartëse sipas modelit të rivlerësimit me 31 dhjetor 2024 (100,000 x 44/45)	<u>(97,778)</u>
Total përfitimi në rivlerësim	17,222

Vlera bartëse sipas modelit të kostos me 31 dhjetor 2024 (125,000 x 44/50)	110,000
Përfitimi për tu raportuar në fitim ose humbje (110,000 - 97,778)	12,222
Përfitimi për tu raportuar në TTGJ (115,000 - 110,000)	<u>5,000</u>
	17,222

L14. Prona, fabrika dhe paisjet	€'000
Ndërtesa me VD në 31 dhjetor 2024	115,000
Fabrika dhe paisjet:	
Kosto	155,000
Minus zhvl i akumuluar (35,500 + 17,925)	<u>(53,425)</u>
	<u>101,575</u>
	216,575

L15. Emetimi i aksioneve	€'000
Akzionet e zakonshme në fund	60,500
Minus emetimi bonus $1/(1+4) \times 60,500$	(12,100)
Minus emetimi në vlerën e drejtë $16,800 \times 0.50$	<u>(8,400)</u>
Akzionet e zakonshme në fillim	40,000
Premia e aksioneve me 31 dhjetor 2024	32,500
Emetimi bonus (anulimi i transferimit në aksione të zakonshme)	12,100
Minus premia në emetimin sipas vlerës së drejtë $8,400 \times 25\%$	<u>(2,100)</u>
Premia e aksioneve në fillim	42,500

4. Më poshtë janë pasqyrat financiare të Dragoti sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 me pasqyrën krahasuese të pozitës financiare për 31 dhjetor 2023.

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	€'000
Të hyrat	9,550
Kosto e shitjeve	<u>(6,550)</u>
Fitimi bruto	3,000
Shpenzimet operative	(750)
Kosto financiare	<u>(75)</u>
Fitimi para tatimit	2,175
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(675)</u>
Fitimi për vitin	1,500
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Të ardhurat nga rivlerësimi	<u>350</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	1,850

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:

	2024	2023
	€'000	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	4,725	4,575
Pasuritë e paprekshme	<u>1,625</u>	<u>750</u>
	6,350	5,325
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	3,550	2,350
Të arkëtueshmet tregtare	2,475	1,700
Paraja	<u>175</u>	<u>-</u>
	<u>6,200</u>	<u>4,050</u>
Total pasuritë	12,550	9,375
Ekuiteti dhe detyrimet		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	1,875	1,250
Premia e aksioneve	875	250
Rezerva e rivlerësimit	350	-
Fitimet e mbajtura	<u>4,725</u>	<u>4,000</u>
	7,825	5,500
<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
10% nota krediti	750	250
Grantet qeveritare	650	750
Tatimi i shtyrë	<u>775</u>	<u>350</u>
	2,175	1,350
<i>Detyrimet afatshkurtra:</i>		
Të pagueshmet tregtare	2,188	1,825
Mbitërheqja bankare	-	288
Interesi i përlogaritur në notat e kreditit	37	12
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>325</u>	<u>400</u>
	2,550	2,525
Total ekuiteti dhe detyrimet	12,550	9,375

Informacioni shtesë i mëposhtëm është i rëndësishëm:

- i) Zhvlerësimi i pronës, fabrikës dhe pajisjeve për vitin në vlerë prej €800,000 dhe një humbje nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve në vlerë prej €125,000 janë përfshirë në koston e shitjes.
- ii) Pasuritë e paprekshme përfaqësojnë shpenzime të kapitalizuara të zhvillimit. Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2024, Dragoti sh.a përfundoi me sukses zhvillimin e një kimikati të barërave të këqija, duke kapitalizuar €1,250,000 të tjera përpara shpenzimeve të amortizimit për periudhën.
- iii) Dragoti sh.a rivlerësoi ndërtesat e saj me €500,000. €150,000 janë transferuar nga teprica e rivlerësimit në fitimet e pashpërndara si një rregullim në fund të vitit në lidhje me zhvlerësimin shtesë të krijuar nga rivlerësimi. Për më tepër, fabrika e re u ble gjatë vitit me një kosto prej €625,000 dhe një grant qeveritar prej €125,000 u mor në lidhje me këtë blerje.
- iv) Dragoti sh.a diversifikoi burimet e saj të financimit duke emetuar aksione për para gjatë vitit.
- v) Dragoti sh.a ka paguar dividendë për aksionerët e saj gjatë vitit.

Kërkohet:

Përgatitni një pasqyrë të rrjedhave të parasë për Dragoti sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 në përputhje me SNK 7 Pasqyra e rrjedhave të parasë. (20 pikë)

4.

Dragoti sh.a

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	€'000
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:</i>	
Fitimi para tatimit	2,175
Shto: Shpenzimet e zhvlerësimit	800
Humbja në shitjen e PFP-së	125
Amortizimi i shpenzimeve të zhvillimit (L11)	375
Kosto financiare	75
Minus amortizimi i grantit (L14)	<u>(225)</u>
	3,325
Rritja në stoke (3,550-2,350)	(1,200)
Rritja në të arkëtueshmet tregtare (2,475-1,700)	(775)
Rritja në të pagueshmet tregtare (2,188-1,825)	<u>363</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet	1,713
Interesi i paguar (L16)	(50)
Tatimi i paguar (L17)	<u>(325)</u>
Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative	1,338
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:</i>	
Blerja e PFP (L12)	(625)
Shpenzimet e zhvillimit	(1,250)
Arkëtimet nga shitja e PFP (L13)	50
Granti i pranuar	<u>125</u>
Neto paraja e përdorur në aktivitetet investuese	(1,700)
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:</i>	
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve:	
[(1,875+875) - (1,250+250)]	1,250
Kredia e pranuar (750-500)	500
Dividenda e paguar (L15)	<u>(925)</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese	825
Neto rritja në paranë dhe ekuivalentët e parasë	463
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2024	<u>(288)</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2024	175
Llogaritjet	€'000
1. Amortizimi i shpenzimeve të zhvillimit	
Saldo në fillim	750
Plus shtesat	1,250
Minus saldo në fund	<u>(1,625)</u>
Amortizimi	375
2. Vlera bartëse e pasurisë së shitur	
Saldo në fillim	4,575
Rezerva e rivlerësimit	500
Plus blerjet	625

Minus shpenzimet e zhvlerësimit	(800)
Minus saldo në fund	<u>(4,725)</u>
Vlera bartëse e pasurisë së shitur	175

3. Arkëtimet nga shitja

Arkëtimet nga shitja (saldo balancuese)	50
Plus fitimi në shitje	<u>125</u>
Vlera bartëse e pasurisë së shitur	175

4. Amortizimi i granti qeveritar (njohje si e hyrë)

Saldo në fillim	750
Plus granti i pranuar gjatë vitit	125
Minus saldo në fund	<u>(650)</u>
Amortizimi i grantit	225

5. Dividenda e paguar

Fitimet e mbajtura në fillim	4,000
Plus fitimi i vitit	1,500
Plus transferi nga rezerva e rivlerësimit	150
Minus saldo në fund	<u>(4,725)</u>
Dividenda e paguar	925

6. Interesi i paguar

Saldo në fillim	12
Plus ngarkesat gjatë vitit	75
Minus saldo në fund	<u>37</u>
Interesi i paguar	50

7. Tatimi i paguar

Saldo në fillim (400+350)	750
Plus ngarkesat gjatë vitit	675
Minus saldo në fund (325+775)	<u>(1,100)</u>
Tatimi i paguar	325

8. Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim dhe në fund.

	2024	2023
Paraja	175	-
Mbitërheqja bankare	<u>-</u>	<u>(288)</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	175	(288)

5.

a) Kontabilisti financiar i Rydes sh.a po finalizon pasqyrat financiare të Rydes sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. Rydes sh.a ka një normë të tatimit në fitim prej 30%. Zërat e mëposhtëm janë duke u konsideruar për qëllime të tatimit të shtyrë:

- Në fund të vitit, prona, fabrika dhe pajisjet e Rydes sh.a kishin bazë tatimore dhe vlerë kontabël prej €72 milionë dhe €95 milionë respektivisht.
- Provizioni i Rydes sh.a për kostot e dekontaminimit ishte €11 milionë (e skontuar në mënyrë të duhur) në fund të vitit. Kostot e dekontaminimit janë të zbritshme për qëllime tatimore kur paguhen.
- Rydes sh.a kishte stocqe me vlerë bartëse prej €24 milionë. Kjo nuk përputhej me bazën tatimore për shkak të fshirjes prej €3 milionë për artikujt e vjetëruar. Vetëm stocqet e shitura dhe jo ato të vjetëruara janë të zbritshme për qëllime tatimore.
- Rydes sh.a ka shkaktuar kosto €15 milionë në lidhje me zhvillimin e softuerit të ri gjatë vitit i cili u kapitalizua dhe do të amortizohet gjatë 5 viteve të ardhshme. Zhvlerësimi i plotë i vitit kërkohet në vitin e parë të përfundimit ose blerjes. Kjo kosto prej €15 milionë është zbritur në vitin aktual për qëllime tatimore.

Kërkohet:

Llogaritni pasurinë/detyrimin e tatimit të shtyrë të Rydes sh.a më 31 dhjetor 2024.

(6 pikë)

b) Biberi sh.a është një nga kompanitë kryesore të argëtimit në Kosovë, e cila krijon dhe siguron të drejtat për përmbajtje. Biberi sh.a ka hyrë në transaksionet e mëposhtme gjatë vitit financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2024:

- i) Më 1 janar 2024, Biberi sh.a bleu të drejtat e vetme të shpërndarjes në Kosovë për një pako të veçantë dixhitale për argëtim në shtëpi. Të drejtat u blenë për €5.25 milionë gjatë një periudhe trevjeçare. **(3 pikë)**
- ii) Biberi sh.a filloi punën për ndërtimin e markës dhe rritjen e shitjeve të pakos të veçantë dixhitale në (i) më lart më 1 janar 2024. Për shkak të suksesit të madh të kësaj përpjekjeje, marka "Biberi" u bë e njohur. Biberi sh.a dëshiron të përfshijë markën në pasqyrat e saj financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 me vlerën e drejtë të vlerësuar prej €30 milionë. **(2 pikë)**
- iii) Biberi sh.a dëshiron të përsërisë suksesin e tij në Kosovë duke e shitur produktin edhe në Shqipëri. Biberi sh.a ka shpenzuar €1.25 milion gjatë vitit duke hulumtuar tregun e Shqipërisë dhe dëshiron të kapitalizojë këtë shpenzim si një pasuri të paprekshme. **(2 pikë)**

Kërkohet:

Në secilin prej skenarëve (i) deri (iii) më sipër, rekomandoni trajtimin e duhur kontabël për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 në përputhje me SNK 38: Pasuritë e paprekshme.

(total 7 pikë)

- c) Ukaj sh.a është një kompani ndërtimi lokale. Rregullorja në sektorin e ndërtimit kërkon që punëdhënësit të sigurojnë pajisje mbrojtëse personale për çdo punonjës. Ukaj sh.a dështoi ta bëjë këtë dhe një punonjës u përfshi në një aksident gjatë punës, duke rezultuar në një dëmtim serioz dhe të kushtueshëm. Punonjës ka paditur kompaninë Ukaj sh.a.

Avokatët e Ukaj sh.a-së janë përgatitur për të mbrojtur kompaninë nga padia. Ata vlerësuan se kompania do të duhej të pagonte një kompensim prej €17,000 për të mbuluar shpenzimet e palës së dëmtuar. Megjithatë, një vendim gjykate nuk pritet për të paktën një vit.

Kërkohet:

Cilat aspekte të kornizës konceptuale mund t'ju ndihmojnë në përcaktimin e trajtimit kontabël të përshtatshëm për këtë situatë? (4 pikë)

- d) Lolis sh.a është një kompani e madhe prodhuese. Kudo që është e mundur, aj strukturon operacionet e tij për të përfituar nga çdo ndihmë financiare e disponueshme nga autoritetet kombëtare dhe rajonale.

Gjatë vitit, Lolis sh.a vendosi të zhvendosë disa nga operacionet e tjera të saj në Mitrovicën Veriore, e cila ofron kosto tërheqëse të punës dhe stimuj tatimorë. Komuna e Mitrovicës ra dakord të kontribuojë me €200,000 si rezultat i vendosjes së Lolis sh.a në Mitrovicën Veriore. Nuk ka kushte të veçanta se për çfarë duhet të shpenzohen paratë. Paratë e gatshme u morën më 1 gusht 2024.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 20 Kontabiliteti për grante të qeverisë dhe shpalosja e asistencës së qeverisë shpjegoni trajtimin e raportimit financiar të ngjres më sipër në pasqyrat financiare të Lolis sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024. (3 pikë)

5.

a)

	Shuma bartëse	Baza tatimore	Diferenca të përkohshme të (zbritshme)/tatueshme	Tatimi i shtyrë 30%
	€'000	€'000	€'000	€'000
Prona, fabrika dhe pajisjet	95,000	72,000	23,000	6,900
Provizioni për kontaminim	(11,000)	-	(11,000)	(3,300)
Stoqet	24,000	27,000	(3,000)	(900)
Zhvillimi i softuerit	<u>12,000</u>	<u>-</u>	<u>12,000</u>	<u>3,600</u>
Total	120,000	99,000	21,000	6,300

Pasuritë e tatimit të shtyrë = 3.3 + 9 = 4.2 milionë.

Detyrimi i tatimit të shtyrë = 6.9 + 3.6 = 10.5 milionë.

Detyrimi i tatimit të shtyrë (neto) është €6.3 milionë.

b)

- i) Kjo është një pasuri e paprekshme, e blerë si një pasuri e veçantë për shuma monetare. Kjo duhet të kapitalizohet me kosto €5.25 milionë. Pasuria duhet të amortizohet gjatë jetës së saj të dobishme ekonomike, në këtë rast 3 vjet. Amortizimi që do të ngarkohet në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 është €1.75 milionë.

	€'milion	€'milion
Në njohjen fillestare		
Debi Pasuria e paprekshme	5.25	
Kredi Paraja		5.25
Në fund të vitit		
Debi Fitimi ose humbja	1.75	
Kredi Amortizimi i akumuluar		1.75

- ii) Marka Biberi bën pjesë në kategorinë e një pasurie të paprekshme të gjeneruar nga brenda. Sipas SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*, pasuritë e krijuara nga brenda nuk mund të njihen përveç nëse mund të vlerësohen duke iu referuar një tregu aktiv të pasurive identike. Është e qartë se çdo markë është unike, kështu që, sipas përkufizimit, nuk mund të ketë një treg aktiv në asete identike. E ngjashme, ndoshta, por identike, jo.

Përrjashtimi tjetër nga rregulli i mosnjohjes është rasti i kostove të zhvillimit. Zhvillimi i një marke nuk i plotëson kriteret për kapitalizimin e kostove të zhvillimit. Prandaj, kostot e zhvillimit të markës duhet të shpenzohen dhe vlera e drejtë e markës mund të mos njihet sipas SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*.

- iii) Ky shpenzim hyn në kategorinë e hulumtimit të tregut. SNK 38 *Pasuritë e paprekshme* në mënyrë specifike përjashton kapitalizimin e hulumtimit të tregut. Prandaj, €1.25 milion duhet të shpenzohen në momentin e ndodhjes.

- c) Përkufizimi i detyrimit mund të ndihmojë në vendosjen e trajtimit kontabël të situatës. Sipas kornizës konceptuale, një detyrim është një obligim aktual i entitetit që rrjedh nga

ngjarjet e kaluara, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë në një dalje entiteti të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Në këtë rast, ngjarja e kaluar është rënia dhe lëndimi i punonjësit.

Detyrimi aktual varet nga probabiliteti i pagesës. Avokatët kanë këshilluar që një humbje prej €17,000 është e mundshme. Prandaj, kontabiliteti i duhur përfshin njohjen e një detyrimi për pagesën e mundshme. Një shpenzim do të njihet gjithashtu.

d)

Kontributi prej €200,000 nga Komuna e Mitrovicës nuk varet nga ndonjë aktivitet i veçantë i kompanisë. €200,000 duhet të kreditohen drejtpërdrejt në fitim ose humbje pasi nuk kompenson shpenzime specifike.